

STATUT

I SHOQERISE "FAST EAGLE SECURITY" Sh.p.k.

KAPITULLI 1

Dispozita te Pergjitheshme

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "FAST EAGLE SECURITY" Sh.p.k eshte person juridik e krijuar sipas te drejtes shqiptare, themeluar sipas akt themelimit

dhe ketij statuti te perpiluar dhe nenshkruar nga ortaku I saj bazuar ne "Ligjin" Nr. 9901, date 14. 04. 2008

"Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" Ligjin Nr. 75 / 2014 Per Sherbimin Privat te Sigurise Fizike"

KREU 1

Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia

NENI 1

Emri

Emertimi I shoqerise me pergjegjesi te kufizuar eshte "FAST EAGLES CURITY" Sh.p.k.

Themeluesja e shoqerise eshte: Znj.Hajrie Hidri shtetase shqiptare, e bija i Nezirit, lindur me 22/09/1986 ne Burrel, dhe banuese ne Tirane, Rr. Tre Vellezerit Konti me nr. personal 165922007K madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Neni 2

Objekti i Shoqerise

1. Sigurimi fizik I objekteve shtetore dhe private, I personave, si dhe I veprimtarive Social – Kulturore, Sportive, Fetare e Politike.

Sigurimi dhe shoqerimi I vlerave monetare, materiale dhe I sendeve te çmuara gjate transportit.

2. Per realizimin e objektit te percaktuar me siper, shoqeria dhe stafi i saj i trajnuar kane te drejte dhe jane te detyruar

te perdore/in mjete dhe pajisje elektronike, arme zjarri, qen sherbimi, mjete e pajisje sherbimi, duke marre masat

perkatese per parandalimin e pasojave pertej atyre te parashikuara me ligj, konform Nenit 32 e vijues te ligjit 75/2014.

3. Shoqeria do te kryeje sherbime te kategorise "Licence Sherbimi i ruajtjes dhe/ose sigurise fizike", nenkategorite 1 /3.A dhe 1 /3.B, konform ligjit nr. 10081 date 23.02.2009 "Per licensat, au torizimet dhe lejet ne Republiken e Shoqerise dhe VKM nr. 538 date 26.05.2009.

Neni 3

Adresa e Shoqerise

Shoqeria do ta kete seline e saj ne Tirane, me adrese: Tirane, Farke, Mjull Bathore, prane rethrotullimit TEG, zk.2704, nr.pasurie 479/8

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale, mbrenda dhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te ortakut te vetem te shoqerise.

NENI 4
Kohezigjatja e Shoqerise

Kohezigjatja e Shoqerise eshte per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit (Regjistrimit)

KREU 2
KAPITALI

NENI 5

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 100,000 (njeqind mije) leke dhe I konvertuar ne nje kuote, qe I takon ortakut themelues.

Ortaku themelues znj. Hajrie Hidri qe zoteron nje kuote me vlere te pergjithshme 100,000 leke qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.

NENI 6

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre,(pasuri te luajtshme apo te paluajtshme) ose mund ta zvogeloje ate, por jo nen kufirin minimal te parashikua me ligj.

Ortaku I vetem eshte organi vendimmarres per rritjen dhe zvogelimin e kapitalit.

NENI 7

Transferimi i Kapitalit

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes;
- c) trashegimise;
- ç) dhurimit;
- d) cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me vendim te ortakut te vetem, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashedimie.

KREU III
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

NENI 8
Organi Vendimmarres

Shoqeria eshte e organizuar ne organet e meposhteme:

1 – Ortaku i Vetem

2- Administratori

NENI 9 Ortaku I vetem

Organi me I larte vendimmarres I Shoqerise eshte Ortaku I Vetem I cili eshte zoteruesi I kuotes te shoqerise. Ortaku I vetem pergjigjet per humbjet e Shoqerise deri ne vleren e pashlyer te kapitalit te nenshkruar.

Te gjitha vendimet qe merren nga Ortaku I Vetem duhet te regjistrohen ne regjistrin e vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Vendimet duhet te regjistrohen ne regjistrin e vendimeve ne rast te kundert ato jane te pavlefshme.

Ortaku I vetem mund te marre vendime ne vende te ndryshme nga selia.

NENI 10 Kompetencet e Ortakut te Vetem

Ortaku I vetem merr vendime te zakonshme per çeshtjet si vijon:

- a) Vendos politikat e biznesit
- b) Emeron, dhe shkarkon administratorin / et
- c) emerom dhe shkarkon ekspertin kontabel te autorizuar;
- d) miraton raportet e ecurise se biznesit;
- e) ben cdo ndryshim ne planin per nxitjen e administrimit ose miraton nje plan te ri per nxitjen e administrimit;
- f) miraton ose ndryshon çdo plan biznesi ose buxheti;
- g) bashkon ose formon nje filial te ri, merr persiper ose blen pjese kapitali ose siguri te tjera te çdo shoqerie;
- h) perfaqeson Shoqerine ne gjykate dhe ne procedime te tjera kunder Administratorit / eve;
- j) per çdo çeshtje tjeter te caktuar nga ligji ose nga ky statut.

Ortaku I Vetem mund te marre vendime te jashtezakonshme per çeshtjet e meposhtme:

- a) Ndryshime ose shtesa ne Statutin e Shoqerise;
- b) Rritja ose zvogelimi I kapitalit te shoqerise
- c) Miratimi I deklarates se llogarive vjetore mbi shperndarjen e fitimeve vjetore;
- d) Ndarja e kuotave
- e) Emerimin dhe shkarkimin e likujdatorit / ve dhe percaktimin
- f) Ristrukturimi dhe shperberja e shoqerise.

NENI 11
Administratori

1. Shoqeria administrohet nga nje administrator, Administratore e shoqerise eshte Znj. Hajrie Hidri shtetase shqiptare, e bija e Nezirit, lindur me 22/09/1986 ne Burrel, dhe banuese ne Tirane, me nr. personal 165922007K.
Administratorja emerohet per nje kohezgjatje prej 5 (pese) vite financiare me perjashtim te rasteve te doreheqjes ose shkarkimit te parakohshem, me te drejte riemerimi.

NENI 12
Kompetencat e administratorit

Administratori eshte pergjegjes per ceshtjet e perditshme te Shoqerise dhe perfaqesoje shoqerine ne marredhenie me te tretet, ne perputhje me dispozitat e Statutit ose ligjit te zbatueshem.

Administratori ka te gjitha kompetencet e zakonshme dhe te jashtezakonshme per administrimin e shoqerise, pervec atyre qe sipas statutit ose ligjit te zbatueshem I takojne ortakut te vetem.

Ne rast te me shume se nje Administratori, Ortaku I vetem mund te vendose qe nje ose me shume Administratore te cilet mund te veprojne bashkarisht ose vec e vec.

Administratori/ et kane kompetencat dhe detyrat e meposhtme:

- a) Te mbikqyre / in dhe te zbatoje / ne politiken e biznesit te shoqerise;
- b) Me kerkese te Ortakut te Vetem, te marre / in masa, te cilat jane ne kompetence te ketij te fundit, te rekomandoje / ne vendime per tu miratuar nga Ortaku I Vetem dhe ti zbatoje / ne keto vendime;
- c) Te sigurohet/ en qe shoqeria zbaton ligjet dhe standartet e mbajtjes se llogarive;
- d) Te siguroje/ neqe deklarata e llogarive vjetore si dhe raporti I ecurise se biznesit dhe çdo deklarim tjetër I detyrueshem sipas ligjit te zbatueshem ose Statutit jane bere siç duhet;
- e) Te shqyrtoje/ ne dhe te mbaj / ne librat e shoqerise, dokumentat dhe aktivet.
- f) Çdo detyre tjetër te caktuar nga ligji ose Statuti.

Administratori /et e Shoqerise mund te largohet/ en nga detyra ne çdo kohe me vendim te Ortakut te vetem.

NENI 13
Pergjegjesite e Administratorit

Administratorja eshte pergjegjese individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"

1.) Administratori detyrohet:

- a) Te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke I kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis;
- b) Te ushtroje kompetencat qe I njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;

- c) Te vleresoje me pergjegjesi ceshtjet, per te cilat merret vendimi;
- ç) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, present apo te mundshem, te interesave personale me ata te shoqerise;
- d) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem.

2. Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjen ndaj shoqerise per cdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

3. Nese administratori vepron ne kundersiztim me detyrat dhe shkel standartet profesionale sipas pikave 1 e 2 te ketij neni, eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standarteve te kerkuara, Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata pergjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.

NENI 14 DREJTUESI TEKNIK

Shoqeria ka ne perberje te personelit te ruajtjes dhe te sigurise fizike Drejtuesin Teknik, I cili eshte I pajisur / pajiset me Certifikaten perkatese per ushtrimin e profesionit dhe ploteson kushtet e parashikuara ne Ligjin 75/ 2014 date 10. 07. 2014 ‘‘ Per Sherbimin Privat te Sigurise Fizike’’.

Drejtuesi Teknik eshte Drejtuesi me I larte I shoqerise dhe pergjegjes per drejtimin, menaxhimin dhe kontrollin e veprimtarise se sherbimit privat te sigurise fizike.

Kur per shkaqe te ndryshme te largimit te Drejtuesit Teknik, titullari I subjektit te SHPSF- se njofton menjehere Drejtorine e Pergjithshme te Policise, dhe mbrenda 15 diteve, duhet te aplikojte per certifikim e tij, sipas dispozitave te ligjit.

Drejtuesi teknik njofton menjehere organin e Policise se Shtetit per cdo ngjarje qe ndodh ne objektet qe shoqeria ka ne ruajtje, si dhe siguron bashkepunim te vazhdueshem me strukturat e policise.

NENI 15 Viti financiar

Viti financiar I Shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti I pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

NENI 16 Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjitha dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomik tregtare te shoqerise, ate gjitha vjetor dhe ate ne lidhje me kontrollat periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte I ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille I ngarkuar nga ana e Ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor, si dhe per kontrollat periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe Ortakut per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

NENI 17

Prishja dhe Likujdimi I Shoqerise

Shperndarja ose prishja e Shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a) kur mbaron kohezgjatja, per te cilen eshte themeluar;

- b) me vendim te Ortakut te Vetem;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
- d) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi I veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te Ligjit Nr. 9723, date 03. 05. 2007 " Per Regjistrimin e Biznesit"
- e) me vendim te gjykates;

Ne kete rast Ortaku I vetem merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likujdimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likujdatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likujdatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likujdim e siper".

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likujdimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

Likujdimi kryhet nga likujduesit e emeruar nga Ortaku.

Nese Ortaku I Vetem nuk merr nje vendim per emerimin e likujduesve, mbrenda 30 diteve pas prishjes, çdo person I interesuar mund ti drejtohet gjykates, per te caktuar nje likujdues.

NENI 18

Riorganizimi I Shoqerise bashkimi - ndarja

Shoqeria mund te ndahet , bashkohet sipas Vendimit te Ortakut te Vetem, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Ligjin 9901 date 14. 04.2008 (ndryshuar) " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

NENI 19

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin ne perputhje te plote me kete Statut dhe dispozitat e legjislacionit Shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete Statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë
- Ligji nr 9901 date 14,04,2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", I ndryshuar
- Ligji nr,9723 date 03,05,2007 "Per Regjistrimin e Biznesit", i ndryshuar
- Ligj Nr,131/2015 "Per Qendren Kornbetare te Biznesit"
- Ligji Nr,75/2014 date 10/07/2014 "Per Sherbimin Privat te Sigurise Fizike", i ndryshuar
- Ligji 9920 date 19,05,2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperiss", i ndryshuar

Neni 20

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij akti themelimi si dhe per cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, kompetente do te jete Gjykata Shqiptare.

Ky statut hartohet dhe nenshkruhet sot me date 05. 12. 2023

ORTAKU I VETEM THEMELUES

I SHOQERISE "TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR"

"FAST EAGLE SECURITY" sh.p.k

Znj. HAJRIE HIDRI

Hajrie Hidri



A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Hajrie Hidri', with a date '2023' written below it. The signature is stylized and somewhat illegible.